



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:261214

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05754386

**C.nr.4443/2023**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, me praktikanten L.S. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses S.F. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 194.87 euro, jashtë seance, me datë 30.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

**I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadija e paditëses S.F. nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, që paditëses të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.08.2022 21.11.2022, në shumën prej 194.87 euro; me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (15.11.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

**A r s y e t i m**

Paditësja S.F. nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 15.11.2023, përmes të autorizuarit të saj A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

Në padi ka theksuar se paditësja është punëtore e arsimit në SHMLM “ Gjon Buzuku” në Prizren dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë

përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me precizimin e padisë me dt. 05.04.2023, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka theksuar se paditësja ka pagën bazë në shumën prej 459.00 euro dhe i takon e drejta në kompensim sipas inflacionit nga data 01.08.2022 deri me datën 21.11.2022, në shumë të përgjithshme prej 194.87 euro dhe atë, për vitin 2022 -  $459 \times 3.66\% = 53.24$  euro për muaj x3 muaj e 20 ditë = 194.87 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 11.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga kontrata me nr. protokollin 332 të datës 07.10.2016 për paditësen e lëshuar nga e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek Shkolla e Mesme “Gjon Buzuku” në Prizren, si mësimdhënëse, që nga data 01.09.2016. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.08.2022-21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 194.87 euro ( $459 * 11.6\% = 53.24 * 3 = 159.72$ ) si dhe periudha 20 ditë të muajit Nëntor është 33.4 euro sipas llogaritjes ( $53.24/30 = 1.77 * 20 \text{ ditë} = 35.49 \text{ euro}$ ), në llogaritje prej  $159.72 + 35.49 = 194.87$ .

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë (15.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padsisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, sepse nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar për plotësimin e padsisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

